

## **Akt i Themelimit**

### **I CAN TRAVEL Sh.p.k**

#### **Neni 1**

##### **Emri**

- 1.1 Sot, më datë 01.09.2022 krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, emri i së cilës është **I CAN TRAVEL Sh.p.k**, në vijim e referuar shkurt si “**Shoqëria**”. Emri tregtar i shoqërisë është **I CAN TRAVEL**.

#### **Neni 2**

##### **Themelimi.**

- 2.1 Shoqëria themelohet bazuar në legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me këtë Akt Themelimi dhe me Statutin e saj.

#### **Neni 3**

##### **Selia**

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “**TRE DESHMORET**” Nd. 100; H 1, Apt 10, Njesia Bashkiake 14, Tirane.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

#### **Neni 4**

##### **Ortakët e Shoqërisë**

- 4.1 Ortakët dhe themeluesit e Shoqërisë janë:
1. **Amr Fahmy Emam Ali Nasreldin**, shtetas Egjiptiane, lindur me 10.12.1978 ,ne Egjipt , identifikuar me pasaporte A25622893 zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkuara në shumën prej **5.100 LEKE** (pese mije e njeqind), të cilat përfaqësojnë **51 %** të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
  2. **Merna Ayman Ali Mohamed Salem**, shtetas Egjiptian lindur me 10.01.1994 ne Egjipt identifikuar me pasaporte Nr. A25343735 zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkuara në shumën prej **4.900 LEKE** (kater mije e nente qind), të cilat përfaqësojnë **49 %** të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

#### **Neni 5**

##### **Kapitali Themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën **10.000 Lekë** (*dhjete mije*),i ndarë në 2 (kater) kuota, me vlerë sipas nenit 4 me sipër.

- 5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para, plotësisht të nënshkruara dhe paguara dhe zotërohet nga ortakët e Shoqërisë sipas Nenit 4 të këtij Akti Themelimi.
- 5.3 Kuotat, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë sipas parashikimeve statutores, janë lirish të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuara nga ligji dhe/ose statuti.

#### **Neni 6** **Objekti**

- 6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon:

“Shërbime Turistike incoming dhe outgoing. Organizim i shërbimeve të grupeve turistike vendase dhe të huaja në të gjitha destinacionet mbarëbotërore. Shitje e paketave turistike, Biletave të udhëtimit të cdo lloji, Eskursionet. Akomodimi i individëve dhe/ose grupeve të ndryshme turistike në sturktura akomodimi. Agjensi Udhëtimi/Operator Trustik. Organizimi dhe planifikim eventesh dhe konferencash, Shërbime dhe Konsulencë ligjore, Shërbime Marketingu Online dhe Konsulencë, , përkthime, Automjete me Qera. Shoqëria mund të kryej dhe cdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar sipas legjislacionit Shqipëtarë”.

#### **Neni 7** **Kohëzgjatja**

- 7.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

#### **Neni 8** **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar në, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit/ëve kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit, etj sikurse parashikohet në Statut dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### **Neni 9** **Administrimi i Shoqërisë**

- 9.1 Administratori/ët e parë të Shoqërisë janë:

**Amr Fahmy Emam Ali Nasreldin**, shtetas Egjiptian, lindur me 10.12.1978 ,ne Egjipt , identifikuar me pasaporte A25622893 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.


**Merna Ayman Ali Mohamed Salem**, shtetas Egjiptian lindur me 10.01.1994 ne Egjipt identifikuar me pasaporte Nr. A25343735 madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.


- 9.2 Administratori/ët emërohen për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratorët emërohen dhe/ose shkarkohen nga detyra, në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Ligji i Zbatueshëm**

- 10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 10.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë në lidhje me, ose si rrjedhojë e këtij akti themelimi do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKET THEMELUES**

  
**Amr Fahmy Emam Ali Nasreldin**

  
**Merna Ayman Ali Mohamed Salem**